



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.31

23 mars

2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 19.3.2007	Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2006	557
Rezolutë e Kuvendit datë 19.3.2007	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit të Shërbimit Civil për vitin 2006	557
Dekret nr.5240 datë 23.3.2007	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	558
Vendim i KM nr.123, datë 14.3.2007	Për miratimin e Marrëveshjes shtesë të koncesionit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Marrëveshjen e koncesionit të formës “BOO”, ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës dhe shoqërisë “Teodori” sh.p.k. Tiranë, për ndërtimin e hidrocentraleve në Tërnovë dhe në Zall të Bulqizës”, miratuar me vendimin nr.556, datë 1.8.2003 të Këshillit të Ministrave...	559
Vendim i KM nr.125, datë 14.3.2007	Për një shtesë në vendimin nr.75, datë 6.2.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e pagesave, që kryhen në Entin Rregullator të Telekomunikacioneve”	562
Vendim i KM nr.126, datë 14.3.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për ndërtimin, me koncesion, të hidrocentralit “Egnatia”	562
Vendim i KM nr.127, datë 14.3.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për ndërtimin, me koncesion, të hidrocentraleve “Verbë”, “Mesmal” dhe “Velçan”	563

Vendim i KM nr.128, datë 14.3.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për ndërtimin, me koncesion, të hidrocentraleve “Strelca 1”, “Strelca 2” dhe “Strelca 3”.....	563
Vendim i KM nr.129, datë 14.3.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për ndërtimin, me koncesion, të hidrocentraleve “Lura 1” , “Lura 2” dhe “Lura 3”	564
Vendim i KM nr.130, datë 14.3.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për ndërtimin, me koncesion, të hidrocentralit “Çarshovë”	564
Vendim i KM nr.131, datë 14.3.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për ndërtimin, me koncesion, të hidrocentralit “Tervol”	565
Vendim i KM nr.132, datë 14.3.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për ndërtimin, me koncesion, të hidrocentralit “Vlushë”	565
Vendim i KM nr.133, datë 14.3.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për ndërtimin, me koncesion, të hidrocentralit “Qytezë”	566
Vendim i KM nr.134, datë 14.3.2007	Për disa shtesa në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar.....	566
Vendim i KM nr.136, datë 14.3.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për ndërtimin, me koncesion, të hidrocentraleve “Lengarica 1” dhe “Lengarica 2”	568
Udhëzim i METE nr.165, datë 16.3.2007	Për përcaktimin e skemës së duhur për shtypjen e përqendruar të biletave, shpërndarjen dhe kontrollin e hedhjes së tyre në përdorim.....	568
Vendim i KNSH nr.11, datë 15.3.2007	Për skemën ekzistuese “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë”	569
Vendim i KNSH nr.12, datë 15.3.2007	Për skemën ekzistuese “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”	571
Vendim i KNSH nr.13, datë 15.3.2007	Për skemën ekzistuese “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit institucional”	572
Vendim i KNSH nr.14, datë 15.3.2007	Për skemën ekzistuese “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papuna femra”	574
Vendim i KNSH nr.15, datë 15.3.2007	Për skemën ekzistuese të subvencionimit të hekurudhave.....	575
	Shpallje kërkesë për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të rotondës Fier dhe unazës lindore Fier.....	576

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT
TË AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2006

Kuvendi i Shqipërisë,

- vlerëson veprimtarinë e Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues i pavarur jogjyqësor, në mbrojtje të të drejtave të njeriut;
- mbështet rolin e këtij institucioni për ngritjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës së administratës publike, duke përfshirë organet ekzekutive të gjyqësorit dhe të prokurorisë;
- nxit angazhimin e Avokatit të Popullit në zbulimin dhe denoncimin e shkeljes së të drejtave ligjore të shtetasve nga zyrtarët.

Konstaton:

- Avokati i Popullit ka kryer gjatë vitit 2006 një veprimtari në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin në mbrojtje të interesave të shtetasve;
- Avokati i Popullit, në veprimtarinë e tij të vitit të kaluar, u është përmbajtur objektivave të vendosur nga Kuvendi në rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së këtij institucioni;
- vëllimi i punës së këtij institucioni dhe ankesat e shqyrtuara prej tij, në krahasim me një vit më parë, janë rritur, çka dëshmon për rritjen e besueshmërisë së shtetasve ndaj tij;
- performanca e këtij institucioni ka ardhur duke u përmirësuar në mënyrë të vijueshme;
- nismat e reja për të shkuar sa më pranë popullit dhe shqetësimeve të tij si “ditët e hapura” vlerësohen pozitivisht për impaktin që ato kanë dhënë.

Kuvendi kërkon që për vitin 2007 t’u kushtohet vëmendje e veçantë këtyre objektivave:

- rikonfirmimit të bashkëpunimit me Kuvendin për informimin për shkallën e respektimit të të drejtave të njeriut, si dhe për nxitjen e nismave ligjvënëse;
- mbrojtjes së të drejtave të njeriut, nëpërmjet ndjekjes së rasteve me vetiniciativë për grupe të mëdha njerëzish, shtresa në nevojë, pa përjashtuar raste individuale tipike;
- forcimit e bashkëpunimit me shoqërinë civile, OJF-të dhe median, për të ushtruar një presion pozitiv mbi administratën, me synim rrënjosjen e praktikave të mira administrative;
- vazhdimin të organizimit të praktikës frytdhënëse të “ditëve të hapura” për t’iu afruar sa më shumë publikut dhe për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit të tij;
- ruajtjes së marrëdhënieve të mira të bashkëpunimit me organizmat ndërkombëtarë;
- denoncimit në vijimësi të shkeljeve të të drejtave të shtetasve nga zyrtarët përgjegjës të administratës shtetërore.

19 mars 2007

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL
PËR VITIN 2006

Kuvendi i Shqipërisë,

- njeh dhe vlerëson rolin e Komisionit të Shërbimit Civil, që ligji “Statusi i nëpunësit civil” i jep për mbikëqyrjen e menaxhimit të shërbimit civil;
- thekson se ky institucion i pavarur është organi administrativ që cakton ligji për të zgjidhur ankesat në lidhje me nëpunësit civilë;
- këmbëngul në domosdoshmërinë e vendosjes dhe forcimit të marrëdhënieve ndërinstitucionale ndërmjet Komisionit të Shërbimit Civil dhe institucioneve të tjera të përcaktuara në ligj;
- nxit dhe mbështet kryerjen e reformave në administratën publike, në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Konstaton:

- mosmbajtjen parasysh në veprimtarinë vjetore të Komisionit të Shërbimit Civil të rezolutës së Kuvendit të 16 shkurtit 2006 dhe të detyrimeve që ky institucion duhej të përmbushte vitin e kaluar në ushtrimin e funksionit të tij ligjor;

- tejkalimin përsëri të kompetencave të veta ligjore nga Komisioni i Shërbimit Civil, çka tregon se ky institucion ende s'e ka të qartë funksionin e tij në raport me institucionet e tjera;

- shfaqje të mungesës së objektivitetit dhe rritje në mënyrë artificiale të numrit të ankesave të nëpunësve civilë ndaj administratës publike edhe në rastet e ristrukturimeve të institucioneve qendrore;

- kundërvënie ndaj rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit për marrjen e masave disiplinore ndaj nëpunësve civilë të larguar për shkelje të ligjit;

- njëanshmëri politike dhe subjektivitet në formulimin e raportit vjetor për veprimtarinë e këtij institucioni.

Kërkon për vitin 2007:

- zbatimin rigoroz të detyrave të përcaktuara për Komisionin e Shërbimit Civil në ligjin "Statusi i nëpunësit civil";

- vendosjen e një platforme të qartë për mbështetjen e reformave dhe rritjen e performancës profesionale e të ndershmërisë në administratën publike, në funksion të arritjes së standardeve të domosdoshme për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian;

- hartimin e rekomandimeve dhe ndjekjen e tyre për përmbushjen e sugjerimeve të dhëna në nivel qendror e vendor;

- bashkëpunimin me Këshillin e Ministrave dhe me institucionet e tjera për kryerjen e reformave në administratë, në përputhje me statusin e nëpunësit civil;

- përmirësimin e rolit të Komisionit të Shërbimit Civil për mbikëqyrjen e menaxhimit të burimeve njerëzore në administratën e pushtetit vendor.

19 mars 2007

DEKRET

Nr. 5240, datë 23.3.2007

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9 pika 7 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", si dhe me propozim të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij:

Blerim Nexhmi Rustemi.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr. 123, datë 14.3.2007

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SHITESË TË KONCESIONIT “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOO”, NDËRMJET MINISTRISË SË INDUSTRIISË DHE TË ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË “TEODORI” SHPK TIRANË, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE NË TËRNOVË DHE NË ZALL TË BULQIZËS”, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.556, DATË 1.8.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes shitesë të koncesionit “Për disa shitesa dhe ndryshime në marrëveshjen e koncesionit të formës “BOO”, ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës dhe shoqërisë “Teodori” sh.p.k. Tiranë, për ndërtimin e hidrocentraleve në Tërnovë dhe në Zall të Bulqizës”, miratuar me vendimin nr.556, datë 1.8.2003 të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE KONCESIONI

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOO”, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË INDUSTRIISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË “TEODORI” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE NË TËRNOVË DHE NË ZALL TË BULQIZËS, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.556, DATË 1.8.2003

Në Tiranë, sot më datë, Palët:

OSHA, e përfaqësuar nga z.Zamir Stefani, me autorizimin nr.1721, prot, datë 9.3.2007, të METE-s, dhe

Shoqëria “Teodori” sh.p.k. përfaqësuar nga administratori i saj z.Faik Teodori, me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë Marrëveshje shitesë koncesioni, si pjesë përbërëse e marrëveshjes së koncesionit e formës “BOO”, e lidhur ndërmjet OSHA-së dhe shoqërisë “Teodori” sh.p.k. Tiranë, për ndërtimin e hidrocentraleve në Tërnovë-Valikardhë dhe në Zall të Bulqizës, të miratuar me vendimin Këshillit të Ministrave nr.556, datë 1.8.2003.

HYRJE

Duke pasur parasysh që:

- Shoqërisë “Teodori” sh.p.k. (Koncesionari), gjatë hartimit të projektzbatimit të objektit, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.556, datë 1.8.2003, i rezultuan zgjidhje më të leverdisshme tekniko-ekonomike për ndërtimin e HEC-ve të Tërnovë-Valikardhës, si:

- reduktim i numrit të HEC-ve të Tërnovë-Valikardhës, nga gjashtë hidrocentrale që parashikonte projekti i miratuar më parë, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.556, datë 1.8.2003, në një HEC;

- rritje të prodhimit të energjisë elektrike mbi 3 herë më shumë se në variantin e mëparshëm të miratuar;

- ndarje të ujërave që përdoren për bujqësinë dhe për prodhimin e energjisë elektrike;

- forma e koncesionit nuk ndryshon, pra mbetet “BOO”, ndërsa treguesit kryesorë tekniko-financiarë përmirësohen ndjeshëm dhe e bëjnë këtë koncesion shumë të leverdisshëm;

- OSHA, bazuar në projektin e ri të plotë të zbatimit, është e interesuar për zbatimin e këtij projekti nga ana e koncesionarit, sepse përfitimi është më i lartë si për koncesionarin, ashtu edhe për vendin.

Palët bien dakord që në marrëveshjen bazë të koncesionit, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.556, datë 1.8.2003, të bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Pas titullit, te paragrafi i parë i Marrëveshjes së koncesionit, e lidhur ndërmjet OSHA-së dhe shoqërisë “Teodori” sh.p.k. Tiranë, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.556, datë 1.8.2003, fjalët: “e përfaqësuar nga Ministria e Industrisë dhe Energjetikës”, të zëvendësohen me fjalët: “e përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës”.

Neni 2

Në nenin 1, “Përkufizime”:

- Në paragrafin e dytë, te termi “Marrëveshja e koncesionit”, pas fjalëve: “ky dokument dhe anekset e tij” shtohen fjalët: “sipas nenit 4 dhe nenit 6 të kësaj Marrëveshjeje shtesë koncesioni”.

- te termi hidrocentralet: pas shprehjes “me koncesion të formës “BOO””, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“sipas nenit 4 dhe të nenit 6 të kësaj Marrëveshjeje shtesë koncesioni”.

Neni 3

Në nenin 2 “Objekt i koncesionit”, pas fjalisë së fundit të paragrafit të dytë, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“sipas nenit 4 dhe nenit 6 të kësaj Marrëveshjeje shtesë koncesioni”.

Neni 4

Neni 3 “Karakteristikat e hidrocentraleve”, ndryshon si më poshtë:

Karakteristikat kryesore të hidrocentraleve janë:

Hidrocentrali i Tërnovë-Valikardhës

- Prurja llogaritëse	1.0 m ³ /sek
- Rënia netto	978 ml.
- Fuqia e instaluar	8.385 kW
- Prodhimi vjetor	56.935.350 kWh
- Investimi pa vlerën e makinerive dhe pa vlerën e lidhjes me sistemin el.	426.714.800 lekë

Hidrocentrali i Zallit të Bulqizës

- Prurja llogaritëse	6.9 m ³ /sek
- Rënia netto	90.60 ml.
- Fuqia e instaluar	5.350 kW
- Prodhimi vjetor	25.117.930 kWh
- Investimi pa vlerën e makinerive dhe pa vlerën e lidhjes me sistemin el.	551.506.100 lekë

Neni 5

Në nenin 4 “Detyrimet e koncesionarit”, në vazhdim të paragrafit të parë, pas fjalëve “...dhe kushteve të saj”, shtohen fjalët:

“sipas nenit 4 dhe nenit 6 të kësaj Marrëveshjeje shtesë koncesioni”.

Neni 6

Në nenin 6 “Vlerësimi i investimeve” paragrafi i parë ndryshon si më poshtë:

Mbi bazën e të dhënave të disponueshme deri tani, investimet e nevojshme për objektin e kësaj kontrate janë vlerësuar rreth 978 220 000 lekë (pa vlerën e makinerive dhe pa vlerën e lidhjes me rrjetin elektrik), sipas anekseve 1 dhe 2 bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje shtesë koncesioni.

Neni 7

Në nenin 8 “Programi i punimeve”,

- te pika 1, rreshti i dytë, fjalët “nga hyrja në fuqi e kontratës”, zëvendësohen me fjalët: “nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje shtesë koncesioni”;

- te pika 2, rreshti i dytë, fjalët “nga hyrja në fuqi e kontratës”, zëvendësohen me fjalët: “nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje shtesë koncesioni”.

- te pika 3, rreshti i dytë, fjalët “nga hyrja në fuqi e kontratës”, zëvendësohen me fjalët: “nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje shtesë koncesioni”;

Neni 8

Në nenin 20 “Sanksionet”, paragrafi i dytë ndryshon si më poshtë:

- “Në rast shkeljeje të afatit të përcaktuar në nenin 8, pika 3 të Marrëveshjes bazë të koncesionit, si dhe në rastet e mosrealizimit të vlerës së investimeve të përcaktuara në nenin 6 të Marrëveshjes shtesë të koncesionit, koncesionari do t’i paguajë OSHA-së, për çdo ditë vonesë, penalitetin 0.01 % të vlerës së përcaktuar të investimit”.

Neni 9

Ndryshimet dhe shtesat e përcaktuara në këtë Marrëveshje shtesë koncesioni hyjnë në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët dhe pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Nenet e tjera të Marrëveshjes bazë nuk kanë ndryshuar.

Marrëveshja shtesë e koncesionit mbahet në 8 (tetë) kopje dhe nënshkruhet pa vërejtje nga të dyja Palët.

Për Organin Shtetëror të Autorizuar
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Zamir Stefani

Për koncesionarin
Shoqëria “Teodori” sh.p.k.
Administratori
Faik Teodori

VENDIM
Nr. 125, datë 14.3.2007

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.75, DATË 6.2.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E PAGESAVE, QË KRYHEN NË ENTIN
RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 91 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e një shtese, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pagesat që kryhen në Entin Rregullator të Telekomunikacioneve, të miratuara me vendimin nr.75, datë 6.2.2003 të Këshillit të Ministrave.
2. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PAGESAT QË KRYHEN PRANË ERT-SË

Në listën e pagesave që kryhen pranë ERT-së, pika III, pagesa vjetore të licencës, shtohet:

A)

Tipi i licencës	Pagesa e licencës	Periodiciteti i pagesës
Operatori publik i telekomunikacioneve		
Shërbim publik telefonik i qëndrueshëm për zonat urbane (bashki)	100 000 lekë/bashki	Çdo vit

B)

Tipi i licencës	Pagesa e licencës	Periodiciteti i pagesës
Licencë e përgjithshme		
Ofruesi i shërbimit të telekomunikacioneve	200 000 lekë	Çdo vit

VENDIM
Nr. 126, datë 14.3.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR NDËRTIMIN, ME
KONCESION, TË HIDROCENTRALIT “EGNATIA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të neneve 5 e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për ndërtimin, me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Egnatia”.

2. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të jetë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 127, datë 14.3.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR NDËRTIMIN, ME KONCESION, TË HIDROCENTRALEVE “VERBË”, “MESMAL” DHE “VELÇAN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të neneve 5 e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për ndërtimin, me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve “Verbë”, “Mesmal” dhe “Velçan”.

2. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të jetë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 128, datë 14.3.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR NDËRTIMIN, ME KONCESION, TË HIDROCENTRALEVE “STRELCA 1”, “STRELCA 2” DHE “STRELCA 3”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të neneve 5 e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për ndërtimin, me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve “Strelca 1”, “Strelca 2” dhe “Strelca 3”.

2. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të jetë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 129, datë 14.3.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR NDËRTIMIN, ME KONCESION, TË HIDROCENTRALEVE “LURA 1”, “LURA 2” DHE “LURA 3”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të neneve 5 e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për ndërtimin, me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve “Lura 1”, “Lura 2” dhe “Lura 3”.

2. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të jetë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 130, datë 14.3.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR NDËRTIMIN, ME KONCESION, TË HIDROCENTRALIT “ÇARSHOVË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të neneve 5 e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për ndërtimin, me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Çarshovë”.

2. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të jetë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 131, datë 14.3.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR NDËRTIMIN, ME
KONCESION, TË HIDROCENTRALIT “TERVOL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të neneve 5 e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për ndërtimin, me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Tervol”.
2. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të jetë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 132, datë 14.3.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR NDËRTIMIN, ME
KONCESION, TË HIDROCENTRALIT “VLUSHË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të neneve 5 e 27, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për ndërtimin, me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Vlushë”.
2. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të jetë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 133, datë 14.3.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR NDËRTIMIN, ME
KONCESION, TË HIDROCENTRALIT “QYTEZË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të neneve 5 e 27, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për ndërtimin, me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Qytezë”.
 2. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të jetë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
 3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 134, datë 14.3.2007

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DISPOZITAVE ZBATUESE TË KODIT DOGANOR”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 123.2 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Pas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 247, të shtohen shkronjat “c/1”, “c/2”, “c/3”, “c/4”, e “c/5”, me këtë përmbajtje:

- c/1. Mallrat, të cilat shërbejnë si lëndë e parë për industrinë përpunuese vendase.
- c/2. Mallrat, që depozitohen në magazina publike, me destinacion rieksportin apo për afate të shkurtra kohore, me qëllime logjistike, deri në kryerjen e veprimeve në dogana (1-2 muaj).
- c/3. Mallrat, të cilat janë pjesë ekskluziviteti në tregtim, për tregun e brendshëm dhe atë rajonal.
- c/4. Mallra me destinacion tregtimin në dyqanet e tipit *Duty Free Shop*.
- c/5. Mallra me destinacion furnizimin e bordeve, veprimtarive apo personave të tjerë, që, për shkak të statusit apo legjislacionit shqiptar, përfitojnë mallra të pataksuara me detyrime importi.”.

Neni 2

Në kreun II të titullit III, pas pikës 8 të nenit 248, shtohet pika 9, me këtë përmbajtje:

“9. Subjekti, që aplikon për licencë për ushtrimin e veprimtarisë *duty free*, duhet të plotësojë këto kritere:

a) Të jetë i regjistruar në regjistrin tregtar të Republikës të Shqipërisë dhe të jetë i pajisur me certifikatën tatimore;

b) Të ketë përvojë jo më pak se 5 vjet në fushën e operimit të *duty free* apo të veprimtarive të tjera, të ngjashme;

c) Të ketë qarkullimin vjetor total për tri vitet e fundit, jo më të vogël se 100 000 000 (njëqind milionë) lekë;

ç) Të ketë numër mesatar të punonjësve për tri vitet e fundit, jo më të vogël se 8;

d) Të depozitojë garanci bankare prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh;

dh) Të paguajë një çmim vjetor të pakthyesëm prej 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekësh, për metër katror;

e) Të jetë i pajisur me të drejtat ekskluzive tregtare të markave dhe tipeve të produkteve, që do të tregojë apo me aplikime certifikatash për mallrat elektronike;

ë) Të jetë i pajisur me një sistem menaxhimi elektronik dhe të sigurtë, të mbështetur nga një software, për mbajtjen dhe mirëmbajtjen e inventarit, duke u lidhur drejtpërdrejt me sistemin ASCUDA, të Doganës. Sistemi elektronik duhet të mbështesë riprogramime dhe “Costumise”, për të dhëna shtesë, që mund të kërkohen;

f) Të jetë i pajisur me një sistem skanimit të inventarit si në hyrje dhe në dalje, si dhe të “Bording pass”, të pasagjerëve, që paraqiten si klientë të dyqanit;

g) Të paraqesë pranë Ministrisë së Financave:

i) planin e hollësishëm financiar të biznesit, duke argumentuar qarkullimin vjetor të parashikuar, numrin e mallrave, që do të tregtohen, mënyrën e tregtimit dhe të manifestimit të mallit;

ii) planin organizativ të zhvillimit të biznesit, duke dhënë hollësi për ndarjen e punës;

iii) planin e magazinimit të mallit, ku përfshihen:

- dokumenti i stokut;

- autorizimet;

- gjetja e vendndodhjes së mallit;

- personeli i magazinës;

- dokumentet e përdorura për çdo lëvizje malli.

gj) Të paraqesë metodat e përdorura për auditim të brendshëm apo për kontrollin e veprimtarive, si dhe dokumentimin e këtyre proceseve;

h) Të jetë i pajisur me një sistem ruajtjeje alarmi;

i) Të ketë tregues eficientë ekonomikë për kthimin e qarkullimit vjetor, vitet e kthimit të investimit.

Ngarkohet Ministri i Financave që në rast pas rasti të emërojë komitetin e shqyrtimit të dokumentacionit për licencat e *duty free*, i cili në përputhje me kriteret e përshkruara më sipër, përcakton, në mënyrë të hollësishme dokumentet e plota, teknike dhe financiare, të përzgjedhjes së operatorëve *duty free*. Komiteti, brenda shtatë ditëve, shqyrton dokumentacionin dhe i paraqet Ministrin të Financave praktikatat e operatorëve, të cilët plotësojnë kriteret.

Ministri i Financave, brenda tri ditëve, miraton lëshimin e licencave për operatorët, që plotësojnë kriteret. Licenca është e vlefshme për 7 vjet, me të drejtë rinovimi.”.

Neni 3

Subjektet, që, në ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, janë të pajisura me licenca për ushtrimin e veprimtarisë *duty free*, marrin masat e nevojshme, që, brenda një periudhe tremujore të përshtaten me kriteret e reja.

Në rast se pas kalimit të kësaj periudhe, nuk është plotësuar qoftë edhe një kriter i vetëm, licenca e tyre vlerësohet e pavlefshme.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 136, datë 14.3.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR NDËRTIMIN, ME KONCESION, TË HIDROCENTRALEVE “LENGARICA 1” DHE “LENGARICA 2”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të neneve 5 e 27, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për ndërtimin, me koncesion, të formës “BOT” (Ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve “Lengarica 1” dhe “Lengarica 2”
2. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të jetë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr. 165, datë 16.3.2007

PËR PËRCAKTIMIN E SKEMËS SË DUHUR PËR SHTYPJEN E PËRQENDRUAR TË BILETAVE, SHPËRNDARJEN DHE KONTROLLIN E HEDHJES SË TYRE NË PËRDORIM

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 6 pika 5 të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojrat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, të ndryshuar, si dhe pikës 2, germa “b” dhe “c”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.712, datë 18.12.2006 “Për krijimin, përbërjen, kompetencat dhe mënyrën e funksionimit të Komitetit *ad-hoc* të lojërave të fatit, kazinove dhe hipodromeve”, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

UDHËZON:

1. Shtypja e biletave të lojërave të fatit kryhet nga vetë shoqëritë, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e lojërave të fatit, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi.

2. Ministri përgjegjës për ekonominë, me propozim të Komitetit të Lojërave të Fatit, miraton çdo biletë të re, që hidhet në qarkullim nga organizatori i lojërave të fatit në kategoritë e lojërave aritmetike, lotarive dhe lojërave të fatit sportive. Për këtë qëllim, organizatori paraqet pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën për miratim të biletës, shoqëruar me modelin e biletës së propozuar nga organizatori;

b) Kontratën e lidhur me prodhuesin e biletës;

c) Detaje teknike të lojës dhe biletës;

d) Planbiznesin e zhvillimit të lojës (vetëm për shoqëritë e licencuara në kategorinë e lojërave “Lotari”).

3. Bileta e propozuar nga organizatori duhet të përmbajë elementet si më poshtë:

a) Emrin e shoqërisë;

b) Të përmbajë nënshkrimin e “Miratuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës”;

c) Çmimi i biletës në lekë (përfshijë biletat e lojërave sportive të fatit), ku të përfshihet TVSH-ja;

d) Numri serial i biletës (për biletat e lojës së fatit “bingo” duhet të jetë gjithmonë progresiv);

e) Elementi i sigurisë së biletës;

f) Rregullorja e lojës me çmimet përkatëse për fituesin (për biletat e lotarisë së çastit).

4. Biletat shtypen në mënyrë të përqendruar, në një shtypshkronjë të akredituar brenda ose jashtë vendit.

5. Në kontratën me shtypshkronjën do të përcaktohet data e fillimit të shtypjes së biletave, sasia në copë e biletave, numri serial i biletave, çmimi i shtypjes së biletave, specifikimet teknike të biletave dhe vendosja e elementeve të sigurisë në biletë.

6. Organizatori depoziton pranë Drejtorisë së Licencave dhe Menaxhimit të Kontratave në METE, përpara hedhjes në qarkullim të biletës për kategorinë e lojës “lotari me fitim në çast”, CD me kodet e sigurisë dhe çmimet fituese të biletave si të prodhuara nga shtypshkronja, me të cilën organizatori ka lidhur kontratën. Kjo CD hapet vetëm në përfundim të lojës dhe në prani të organizatorit.

7. Organizatori është i detyruar të depozitojë në METE regjistrin e shpërndarjes së biletave, sipas sallave apo pikave të shitjes në të gjithë territorin e vendit përpara hedhjes në qarkullim të biletës dhe të njoftojë në vazhdimësi për çdo parti të re furnizimi në këto pika shitjeje.

8. Organizatori i lotarisë së çastit/me shorte është i detyruar të publikojë në të gjitha pikat e shitjes së biletave:

a) serinë e plotë të biletave të hedhura në qarkullim në të gjithë territorin e vendit;

b) rregulloren e lojës.

9. METE publikon në faqen e saj të internetit çdo biletë në kategorinë e lojërave të fatit “lotari”, të miratuar nga Ministri përgjegjës për ekonominë dhe serinë e numrave të hedhur në qarkullim.

10. Organizatori i lojës njofton METE në çdo tre muaj mbi xhiron e realizuar nga shoqëria, bazuar mbi shitjen e biletave; sasinë e shitur të biletave dhe çmimet fituese, si dhe derdhjen e detyrimeve tatimore, sipas ligjit.

11. Mbyllja e lojës dhe asgjësimi i biletave bëhet vetëm me miratim të Ministrit përgjegjës për ekonominë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli

VENDIM
Nr. 11, datë 15.3.2007

**PËR SKEMËN EKZISTUESE “PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË
PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË”**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

Z. Genc Ruli	- Kryetar
Znj. Mimoza Dhëmbi	- Anëtare
Znj. Mimoza Vokshi	- Anëtare
Z. Viktor Gumi	- Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.3.2007 shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë””. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me shkresën nr.295, datë 12.2.2007 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr. AI/006/1/2005.

Baza ligjore: Si bazë për dhënien e ndihmës janë nenet 6 dhe 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, si dhe pikat 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.2.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë”.

Objektivi/vat: Skema synon të ndihmojë punëdhënësit, që marrin në punësim të përkohshëm ose në punësim prove persona punëkërkues të papunë nga lista e zyrës së punësimit, nëpërmjet një financimi mujor të pagës dhe të shpenzimeve për sigurimet e detyrueshme të këtyre personave.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndhmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema synon të mbështesë ndërmarrjet që mundësojnë marrjen në punësim të përkohshëm ose në punësim prove të punëkërkuesve të papunë nga lista e zyrës së punësimit.

2. Skema paraqitet shumë komplekse dhe nuk ka kritere të qarta për llogaritjen e intensitetit, për kohëzgjatjen e saj, si dhe për monitorimin e impaktit që sjell zbatimi i secilës prej pikave të vendimit.

3. Në skemë nuk janë parashikuar dispozitat sanksionuese për mospërbushjen nga ana e ndërmarrjeve të detyrimeve të tyre në kuadër të skemës dhe as mënyra e raportimit të institucioneve të ngarkuara me zbatimin e saj.

4. Duke shqyrtuar në tërësi vendimin, si dhe duke marrë parasysh që në analizë përfshihen edhe vlerat e pagesës së papunësisë dhe ndihmës ekonomike është pothuajse e pamundur që, me mënyrën sesi është parashikuar në vendim, por edhe në bazë të të dhënave që janë vënë në dispozicion nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të llogaritet dhe të vlerësohet intensiteti i ndihmës për të gjithë skemën, pra intensiteti total i saj.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 10 shkronja “c”, paragrafi 2 dhe nenit 23 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, si dhe nenit 19 të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005,

PROPOZON:

1. Skema të rishikohet tërësisht, sipas kritereve të përcaktuara në legjislacionin për ndihmën shtetërore.

2. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të përcaktojë saktë vlerën e intensitetit të ndihmës për çdo komponent të dhënë në skemë, si dhe vlerën e intensitetit total në kuadër të gjithë skemës.

3. Të përcaktohet afati përfundimtar i mbarimit të skemës.

4. Të parashikohet që të gjitha ndërmarrjet që nuk plotësojnë detyrimet e tyre në kuadër të skemës, të kthejnë të gjithë ndihmën/subvencionin e marrë, së bashku me interesat.

5. Të parashikohet që autoriteti përgjegjës për zbatimin e skemës duhet të raportojë, brenda datës 31 mars të çdo viti, të dhënat për zbatimin e skemës në vitin paraardhës financiar. Këto të dhëna duhet të ruhen deri në 10 vjet pasi është dhënë ndihma/subvencioni i fundit në kuadër të skemës.

6. Çdo projektakt normativ i Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, lidhur me procedurat dhe kriteret e zbatimit të skemës “Për programin e nxitjes së punësimit, të punëkërkuësve të papunë”, duhet të marrë miratimin paraprak të KNSH-së.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

VENDIM
Nr. 12, datë 15.3.2007

**PËR SKEMËN EKZISTUESE “PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT,
NËPËRMJET FORMIMIT NË PUNË”**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

Z. Genc Ruli	Kryetar
Znj. Mimoza Dhëmbi	Anëtare
Znj. Mimoza Vokshi	Anëtare
Z. Viktor Gumi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.3.2007 shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë””. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me shkresën nr.295, datë 12.2.2007 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.A1/006/2/2005.

Baza ligjore: Si bazë për dhënien e ndihmës është neni 6 i ligjit nr.7995, datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit”, si edhe pika 1 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.73, datë 11.2.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”.

Objektivi/vat: Skema synon të ndihmojë punëdhënësit që angazhojnë për qëllim formimin nëpërmjet punës, të personave punëkërkuës të papunë, të cilët janë persona profesionalisht të pakualifikuar për proceset e punës.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndhmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema përmban dy elemente ndihme: ndihma për trajnim, nëpërmjet formimit në punë për ata që vetëm trajnohen dhe nuk punësohen pas mbarimit të kursit të formimit, si dhe ndihma për punësim, pasi ndërmarrja duhet të punësojë të paktën 40% të numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve në formim.

2. Intensiteti i ndihmës për pikën e parë të vendimit llogaritet të jetë 71,4%, që është më i lartë se kufijtë e përcaktuar në ligjin e ndihmës shtetërore për ndihmën për punësim dhe në rregulloren për ndihmën rajonale për nxitjen e punësimit në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

3. Intensiteti total i skemës tejkalon edhe më shumë kufijtë maksimalë të lejuar në legjislacionin e ndihmës shtetërore.

4. Megjithëse udhëzimi nr.73, datë 14.1.2004 për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.73, datë 11.2.1999, synon të përcaktojë procedurat e kontrollit dhe monitorimin e rezultateve të skemës, në zbatimin praktik ka munguar kontrolli i plotë mbi skemën dhe rezultatet e pritshme të saj.

5. Në skemë nuk është përcaktuar detyrimi për kthimin e ndihmës, nëse ndërmarrjet nuk përmbushin angazhimet e tyre në kuadër të skemës.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 10 shkronja “c”, paragrafi 2, dhe nenit 11 shkronja “a” të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, si dhe nenit 6 të rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.815, datë 28.12.2005,

PROPOZON:

1. Skema të rishikohet duke ndarë në mënyrë të qartë komponentin për trajnim, nga ai për punësim.

2. Që skema të bëhet e lejueshme për pikën 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave, duhet ose të ulet niveli i subvencionit, ose të rritet numri i punonjësve të cilët ndërmarrja është e detyruar të punësojë për të paktën një vit.

3. Pika 2 e vendimit të Këshillit të Ministrave, duhet të hiqet, pasi tejkalon kufirin maksimal të intensitetit të lejuar të ndihmës.

4. Të përcaktohet afati përfundimtar i mbarimit të skemës.

5. Të parashikohet që të gjitha ndërmarrjet që nuk plotësojnë detyrimet e tyre në kuadër të skemës, të kthejnë të gjithë ndihmën/subvencionin e marrë, së bashku me interesat.

6. Të parashikohet që autoriteti përgjegjës për zbatimin e skemës duhet të raportojë brenda datës 31 mars të çdo viti, të dhënat për zbatimin e skemës në vitin paraardhës financiar. Këto të dhëna duhet të ruhen deri në 10 vjet pasi është dhënë ndihma/subvencioni i fundit në kuadër të skemës.

7. Çdo projektakt normativ i Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, lidhur me procedurat dhe kriteret e zbatimit të skemës “Për programin e nxitjes së punësimit, të punëkërkesve të papunë”, duhet të marrë miratimin paraprak të KNSH-së.

8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

VENDIM

Nr. 13, datë 15.3.2007

PËR SKEMËN EKZISTUESE “PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT, NËPËRMJET FORMIMIT INSTITUCIONAL”

Komisioni i Ndhmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

Z. Genc Ruli	Kryetar
Znj. Mimoza Dhëmbi	Anëtare
Znj. Mimoza Vokshi	Anëtare
Z. Viktor Gumi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.3.2007 shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit institucional””. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me shkresën nr.295, datë 12.2.2007 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr. A1/006/3/2005.

Baza ligjore: Si bazë për dhënien e ndihmës për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit institucional, është neni 11 pika 1 e ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, si edhe pikat 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.74, datë 11.2.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet mbështetjes së formimit institucional”.

Objektivi/vat: Skema synon të ndihmojë subjektet, që ofrojnë kurse formimi institucional, në përfundimin e të cilave garantohet punësimi i të paktën të 20% të pjesëmarrësve, si dhe subjektet që ofrojnë kurse formimi institucional për punëkërkuessit e papunë.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndhmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema, në parim, mbulon të gjitha ndërmarrjet/institucionet private, që ofrojnë kurse të formimit institucional për punëkërkuessit e papunë të regjistruar në zyrat e punësimit, me kusht që të garantojnë punësimin me kontratë të rregullt një vjeçare të 20% të pjesëmarrësve në kurs.

2. Në rast se ndërmarrja përfituese punëson mbi numrin e caktuar të punëkërkuessve të papunë, përfiton një shpërblim shtesë deri në tre paga minimale, në shkallë vendi, por nuk ka parashikuar asnjë kufi maksimal lidhur me numrin shtesë që mund të punësohet nga ndërmarrja.

3. Intensiteti për pikën e parë të vendimit është mbi vlerën e intensitetit maksimal të lejuar si ndihmë për trajnim specifik (35%) dhe mbi vlerën e intensitetit maksimal të lejuar si ndihmë për punësimin e personave në vështirësi (50%).

4. Intensiteti i ndihmës për pikën e dytë të vendimit është brenda kufijve të intensitetit maksimal të lejuar për ndihmës për trajnimin e përgjithshëm për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (70%) por mbi kufirin e lejuar për ndërmarrjet e mëdha (50%).

5. Në vendim nuk përcaktohet ndonjë kusht lidhur me vlerën e akumuluar të ndihmës, pra nëse ndërmarrjet që përfitojnë nga pika e parë, mund të përfitojnë edhe nga pika e dytë e vendimit, nuk është përcaktuar nëse këto ndërmarrje mund të përfitojnë nga skema të tjera ndihme, si edhe nuk është përcaktuar afati i përfundimit të skemës.

6. Karakteri i përgjithshëm dhe i papërcaktuar i skemës deformohet në bazë të urdhrave të nxjerrë çdo vit nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, sipas të cilëve bëhet rishikim i grupeve përfitues nga skema, si dhe përzgjedhja e sektorëve që kanë përparësi.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 10 shkronja “c” paragrafi 2 i nenit 11, shkronjat “a” dhe “b”, neni 23 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, neni 19 të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005, si edhe neneve 5 dhe 8 të rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.815, datë 28.12.2005,

PROPOZON:

1. Në mënyrë që skema të jetë e lejueshme, intensiteti i ndihmës së dhënë të rishikohet për pikën e parë të vendimit, duke mos tejkaluar kufijtë e përcaktuar në legjislacionin e ndihmës shtetërore.

2. Për pikën e dytë të vendimit të vendoset kushti që në rastin e ndërmarrjeve të mëdha shteti mund të financojë deri në 50% të kostove të përgjithshme të kursit.

3. Të shtohet një pikë në vendim, ku të parashikohet se në dhënien e mbështetjes financiare ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për përmbushjen e programeve të formimit institucional do të merren parasysh të gjitha format e mbështetjes që ndërmarrja mund të ketë marrë ose merr nëpërmjet programeve të tjera. Vlera e akumuluar e të gjitha formave të ndihmës, në asnjë rast, nuk duhet të kalojë vlerën maksimale të lejuar prej 75%.

4. Të përcaktohet afati përfundimtar i mbarimit të skemës.

5. Çdo projekt aktnormativ i Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, lidhur me procedurat dhe kriteret e zbatimit të skemës “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit institucional”, duhet të marrë miratimin paraprak të KNSH-së.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

VENDIM
Nr. 14, datë 15.3.2007

**PËR SKEMËN EKZISTUESE “PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË
PUNËKËRKUESEVE TË PAPUNA FEMRA”**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

Z. Genc Ruli	Kryetar
Znj. Mimoza Dhëmbi	Anëtare
Znj. Mimoza Vokshi	Anëtare
Z. Viktor Gumi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.3.2007 shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra””. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me shkresën nr.295, datë 12.2.2007 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr. AI/006/4/2005.

Baza ligjore: Si bazë për dhënien e ndihmës për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra janë nenet 4 dhe 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, si dhe pikat 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 18.9.2003 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra”.

Objektivi/vat: Skema synon të ndihmojë punëdhënësit, që punësojnë me kontratë të rregullt, me kohëzgjatje një deri në trevjeçare, punëkërkuese të papuna femra, nga lista e zyrës së punësimit.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndhmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema, në parim, mbulon të gjitha ndërmarrjet/institucionet private, që kanë si qëllim marrjen, në punësim me kontratë të rregullt, punëkërkueseve të papuna femra nga lista e zyrës së punësimit të territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Intensiteti i ndihmës së dhënë për vitin e parë ose dy vitet e para së bashku është respektivisht 35,6% dhe 46,9%, duke qenë brenda kufijve të përcaktuar në ligjin nr.9374 datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, ndërsa kur skema zbatohet për të tre vitet së bashku, intensiteti është 56%, duke tejkaluar vlerën maksimale të përcaktuar në ligj.

3. Karakteri i përgjithshëm dhe i papërcaktuar i skemës, ndryshon me anë të urdhrave të nxjerrë çdo vit nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, sipas të cilëve bëhet rishikim i grupeve përfituese nga skema, si dhe përzgjedhja e sektorëve/ndërmarrjeve që kanë përparësi.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, mbështetur në bazë të nenit 10 shkronja “c” paragrafi 2 dhe nenit 23 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, nenit 19 të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005, si dhe nenit 6 pika 3 të rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.815, datë 28.12.2005,

PROPOZON:

1. Në mënyrë që skema të jetë e lejueshme, intensiteti i ndihmës së dhënë të rishikohet kur skema zbatohet për tre vite ose duke ulur vlerën e kontributit të sigurimeve shoqërore, ose duke ulur numrin e pagave me të cilat kompensohet ndërmarrja.

2. Në rast se nuk merret parasysh propozimi i pikës 1, MPÇSSHB-ja kur zbaton skemën për tre vite, duhet të vendosë kushtin që ndërmarrja të jetë e detyruar të ruajë vendet e punës edhe për të paktën dy vjet pas përfitimit të vitit të tretë të ndihmës.

3. Çdo projekturdhër i Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, lidhur me procedurat dhe kriteret e zbatimit të skemës, duhet të marrë miratimin paraprak të KNSH-ja.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

VENDIM

Nr. 15, datë 15.3.2007

PËR SKEMËN EKZISTUESE TË SUBVENCIONIMIT TË HEKURUDHAVE

Komisioni i Ndhmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

Z. Genc Ruli	Kryetar
Znj. Mimoza Dhëmbi	Anëtare
Znj. Mimoza Vokshi	Anëtare
Z. Viktor Gumi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.3.2007, pasi shqyrtoi argumentet e paraqitura pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, me shkresën nr.1090/1, datë 9.3.2007, lidhur me vendimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr.8, datë 2.2.2007 për skemën e subvencionimit të hekurudhave,

VËREN SE:

1. Argumentet e paraqitura nuk përlligjin mosmarrjen e masave të propozuara në vendimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr.8, datë 2.2.2007 për skemën e subvencionimit të hekurudhave.

2. Për sa i takon kontratës së ofrimit të shërbimit publik, si në gjithë praktikën europiane, ajo është një marrëdhënie juridike që duhet të lidhet midis institucionit mbikëqyrës të veprimtarisë së transportit hekurudhor (në këtë rast Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit) dhe Hekurudhës Shqiptare sh.a. Këshilli Mbikëqyrës, nga ana e tij është një organ drejtues i shoqërisë, që duhet të raportojë edhe në këtë aspekt, sikurse për të gjitha detyrat e tjera të shoqërisë.

3. Edhe kërkesa për mosrespektimin e afateve kohore për ndarjen e llogarive nuk ka shkaqe të përlligjura teknike.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, mbështetur në nenin 23 të ligjit nr.9374, datë 21.2.2005 “Për ndihmën shtetërore”, si dhe në nenet 19 dhe 21 të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshilli të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të masave të propozuara në vendimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr.8, datë 2.2.2007.

2. Në rast moszbatimi të tyre nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Hekurudha Shqiptare sh.a., Komisioni i Ndhmës Shtetërore është i detyruar të fillojë procedurat për ndihmën e paligjshme dhe Hekurudha Shqiptare sh.a. detyrohet të kthejë të gjithë vlerën e subvencionit të marrë, së bashku me interesat.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të rotondës Fier dhe unazës lindore Fier.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur. Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Sqarojmë se në kolonën “Shënime” në tabelën e publikuar, për të gjithë pronarët që është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, paratë do të qëndrojnë të bllokuara në bankë deri në momentin që do të paraqesin dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 3 291 221 (tre milionë e dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e njëzet e një) lekë.

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN SI REZULTAT I
NDËRTIMIT TË ROTONDËS FIER DHE UNAZËS LINDORE FIER

Nr.	Emri	Nr. pasurisë	Sip.m ² truall	Çmimi lekë/m ²	Objekt me vlerë lekë	Vlera lekë	Shënime
1.	Agush Aqif Veliu	5/188	67	10 000		67 000	Plotësim dokumentacioni
2.	Juljan Dashamir Mahmutaj	7/263	54	10 000	2 081 221	2 621 221	Plotësim dokumentacioni
	Totali					3 291 221	

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 042 555 63; ose 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**
 1. **PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006) 1500**
 2. **PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600**
 3. **PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300**
 4. **PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500**

BOTIME TË REJA

1. **TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
2. **TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
3. **TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
4. **TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
5. **PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000**
6. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800**
7. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500**
8. **PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000**
9. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... 500**

Hyri në shtyp më 23.3.2007
 Doli nga shtypi më 23.3.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Grafon"
 Tiranë, 2007

Çmimi: 24 lekë